

Nr. 592 / 08.09.2022
Në bazë të Ligjit për Aftësimin e të Rriturve, neni 16.1, dhe në bazë të ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, Neni 6
Drejtorja Komunale e Arsimit dhe Kulturës në Fushë - Kosovë:

Nr. 577 / 08.09.2022

Shpall:

KONKURS

Shkolla e Mesme "Hoxhë Kadri Prishtina" dhe "Minatori" në Fushë - Kosovë

Drejtimit ekonomike – juridike

- banka dhe sigurime (1 klasë),
- asistent i administratës (1 klasë)
- asistent juridik (1 klasë),
- kontabilitet (1 klasë),
- shpëdicion dhe logjistikë (1 klasë).

Drejtimit Teknike:

- teknik i minierave (1 klasë),
- teknik i energjetikës (1 klasë),
- teknik i telekomunikacionit (1 klasë),
- teknik i informatikës (1 klasë).

Regjistrimi i vijuesve në programin "Arsimi për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në nenin 10.2 (a.b) dhe nenin 17.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë.

Në programin " Arsimi për të Rritur" në shkollat e mesme të larta, vijuesve u mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi (UA .nr.11/2011 MASHT) të datës 30.12.2011. Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Dëftesa e klasave të kryera paraprake,
2. Certifikata e lindjes.

Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ, MASHT Nr. 11/2011.

Pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimin për të rritur në shkollat e mesme të larta profesionale do të jetë:

1. Për regjistrim të vitit të parë për një klasë _____ 100.00 euro,
2. Për dhënien e provimit plotësues dhe diferencial _____ 10.00 euro,
3. Pagesa e praktikës profesionale _____ 50.00 euro.
4. Diploma për klasën e 12-të _____ 20.00 euro.
5. Për provimet përfundimtare të klasës, certifikata _____ 30.00 euro.

Kandidatët të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht t'u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës për të cilën kalendari është paraqitur për regjistrim.

Dëftesat dhe diplomatat që merren në programin "Arsimi dhe Aftësimi për të Rritur" janë të barasvlershme me diplomatat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 10 ditë nga dita e publikimit në shkollë

Data, 08.09.2022

Fushë Kosovë

Zv.drejtor: Ukshin Uka

Zv.drejtor: Rexhep Berisha